VENDIM
Nr.768, datë 24.9.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN HAJMEL, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Hajmel, të qarkut të Shkodrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 447 (katërqind e dyzet e shtatë).

2. Ndryshimet që i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha